



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.Prot.: 13/673

Datë: 26.10.2020

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.037L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 13 dhe 14 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve komunale 01 Nr.060/01-31587/1 i dt. 24.12.2020, Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

K O N K U R S

Për ndarjen e 100 bursave komunale për vitin akademik 2020-2021 për studentat e komunës së Dragashit

I. Kushtet e përgjithshme:

1. Bursat komunale ndahen për studentët e rregullt të komunës së Dragashit të nivelit të studimeve themelore (bachelor) në universitetet publike në Kosovë.
2. Të mos jenë përfitues i bursës nga Universiteti apo Ministria e Arsimit dhe të mos janë të punësuar.
3. Të mos jenë përsëritës të vitit akademik.

II. Të drejtë aplikimi për bursë komunale kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë student të rregullt (bachelor) të fakulteteve të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës.
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
3. Të jenë banorë të komunës së Dragashit
5. Studentët të cilët në vitin akademik 2019/20 kanë pasur statusin e studentit me korrespondencë, nuk kanë të drejtë aplikimi për bursë universitare për vitin akademik 2020/21.

III. Kushtet e veçanta:

1. Fëmijët pa prind (Fëmijët e Dëshmorëve, Martirëve, Invalidëve të Luftës, dhe veteranëve të luftës) - 25 pikë
2. Nota mesatare prej 9 — 10 në fakultete - 20 pikë
3. Nota mesatare prej 8 — 9 në fakultete - 15 pikë
4. Nota mesatare prej 7 — 8 në fakultete - 10 pikë
5. Personat me aftësi të kufizuara - 15 pikë
6. Rastet me gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale - 15 pikë
7. Në kushtet e barabarta të vlerësimit të kriterëve të përshkruara në nenin 14 të Rregullores për kushtet,

kriteret dhe procedurat e ndarjes se subvencioneve të komunës 01 Nr.060/01=31587/1 i dt. 24.12.2020 përparësi kanë fëmijët e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës, viktimave të luftës dhe të familjeve që kanë dy apo me tepër studentë dhe gjendje të rëndë ekonomike.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 2. Aplikacioni sipas formës së Komunës (kërkesën për aplikim dhe fletëparaqitjen)
 3. Kopja e ID-së së studentit;
 4. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 202/2021 (origjinale);
 5. Çertifikata e notave (origjinale);
 6. Vërtetimi që studenti nuk është përfitues i bursës nga Universiteti apo Ministria e Arsimit (origjinale).
 7. (Çertifikata) Ekstrakti i lindjes;
 8. Deklarata e bashkësisë Familjare
 9. Çertifikata për përfundimin e shkollës fillore (kopje). Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti do të konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Dragashit më tepër se 10 vite;
 10. Kopja e letërnjoftimit
 - 11.Vërtetimi nga Administrata Tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune.
 - 12.Për anëtarin e ngushtë të familjes së dëshmorëve edhe Martirëve, Invalidëve të Luftës, dhe veteranëve të luftës:
(Vendimi/Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve)
 13. Për anëtarin e ngushtë të familjes në asistencë sociale edhe:
(Vendimi/Vërtetimi që dëshmon se aktualisht është shfrytëzues i ndihmës sociale (origjinale))
 14. Për studentët me nevoja të veçanta:
(Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale)
- Vërejtje : Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

V. Për përzgjedhjen e përfituesve të bursës komunale Drejtoria për Arsim në Dragash e formon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e bursave dhe pas mbylljes së afatit të konkursit, ky komision në bashkëveprim me Drejtorin e kësaj drejtorie, e kryen procesin e shqyrtimit të kërkesave dhe e harton raportin e punës, të cilin me rekomandime përkatëse ia përcjell Kryetarit të komunës për miratimin e vendimeve për ndarjen e bursave.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

VI. Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në zyrën nr.5 në DKA Dragash.

VII. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e sipërhënuara, zyrtarët e DKA-së nuk do t'i lëshojnë Fletëparaqitjen e cila ua mundëson aplikimin për bursë.

VIII. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin zyrtarët e DKA-së.

IX. Bursat komunale për vitin akademik 2020-2021 do t'u ndahen studentëve të nivelit bachelor, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, ndërsa lartësia e bursës është 500€

X. Afati i aplikimit

1. Afati i aplikimit zgjatë prej datës 27.10.2020 deri më 10.11.2020 në orën 15:00.
2. Në qoftëse gjatë kohëzgjatjes së afatit të aplikimit ka ditë feste, atëherë afati i aplikimit do të shtyhet për aq ditë sa zgjatë festa zyrtare.

XI. Afati i ankesave

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës komunale dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

Ankesat duhet të dorëzohen në zyrën nr.5, në ndërtesën e DKA-së Dragash.

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të DKA-së dhe në web faqen e komunës së Dragashit



Me respekt,

Drejtori i Arsimit në Dragash

MSc.Vloran Cenaj

v.v.